



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M  
K.P.P. 338/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.06.2019, shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Medfau” sh.p.k. dhe “Swissmed” sh.p.k. pjesëmarrës në procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur*”, me nr. REF-07294-02-11-2019, Loti I, me objekt: “*Blerje Reagenë, dhe aksesore të tjerë të nevojshëm për testimet në laboratorin e agjentëve infektivë*”, me fond limit 97.430.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut. Zhvillim jo i rregullt i procedurës së mësipërme të prokurimit”.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Pegasus” sh.p.k.  
Rruga “Siri Kodra”, Nr. 149, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut  
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë
- Subjekt i interesuar:** Operatori ekonomik “Medfau” sh.p.k.  
Lagja 5, Kavajë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 12.02.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedure e Hapur*”, me nr. REF-07294-02-11-2019, Loti I, me objekt: “*Blerje Reagenë, dhe aksesorë të tjerë të nevojshëm për testimet në laboratorin e agjentëve infektivë*”, me fond limit 97.430.000 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 07.03.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- |    |                    |  |
|----|--------------------|--|
| 1. | “Medfau” sh.p.k.   | 3690 lekë (çmim shumator), kualifikuar |
| 2. | “Pegasus” sh.p.k.  | 3760 lekë (çmim shumator), kualifikuar |
| 3. | “Swissmed” sh.p.k. | 3780 lekë (çmim shumator), kualifikuar |

II.3. Në datën 12.03.2019 operatori ekonomik “Pegasus” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4. Në datën 18.03.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, ku kundërshton kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Medfau” sh.p.k. dhe “Swissmed” sh.p.k.

Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon se:

[...]

*Shoqëria Pegasus sh.p.k. mori pjesë në procedurën e prokurimit të zhvilluar me date 07.03.2019, nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut (AK) me objekt Lot. 1 “Blerje Reagente, dhe aksesore te tjere te nevojshem per testimet ne laboratorin e agjenteve infektive”, me fond limit (Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuudër) 97 430 000 (nentedhete e shtate milion e katerqind e tridhete mije) leke pa TVSH, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomikë ku te gjitha kushtet jane të përcaktuara me afat 12 muaj nga data e lidhjes se marreveshjes kuader.*

*Me date 12.03.2019, u njoftuam në SPE për rezultatet e vlerësimit te ofertave nga KVO si vijon:*

<i>Operatoret Ekonomike</i>	<i>Vlera e ofertuar</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>Medfau</i>	<i>3690.00</i>	<i>JO</i>
<i>Pegasus</i>	<i>3760.00</i>	<i>JO</i>
<i>Swissmed</i>	<i>3780.00</i>	<i>JO</i>

*Vlerësimi i mësipërm, nuk eshte në perputhje me kerkesat ligjore ne fuqi, dhe ofertat e paraqitura nga OE Medfau dhe OE Swissmed duhen refuzuar per arsyet si vijon:*

*A. Shkaqe të përbashkëta për refuzimin e ofertave të OE Medfau dhe OE Swissmed*

*l.*

*OE Medfau dhe OE Swissmed kanë ofruar mallrat e kërkuara nga AK (reagentë dhe aksesorë) me kushtin e dhënies në përdorim prej tyre të pajisjes/pajisjeve të ndryshme nga ARCHITECT ci8200 dhe ARCHITECT i2000SR.*

*Njoftimi i Kontratës dhe Dokumentat e Tenderit (DT), që hartohen bazuar në Urdherin e Prokurimit përkatës, kanë përcaktuar që objekti i kontratës është "Blerje Reagente, dhe aksesorë te tjere re nevojshem per testimet ne laboratorin e agjenteve infektive".*

*Pra, na rezulton, se dhenia në përdorim e pajisjes/pajisjeve, është një element që nuk eshte kerkuar nga AK në Dokumentat e Tenderit, cka del jashtë objektit të përcaktuar nga vetë AK në Urdherin e Prokurimit dhe DT.*

*OE Medfau dhe OE Swissmed, e kanë objektivisht të pamundur të ofrojne reagentë dhe aksesorë të tjerë nga prodhuesit e pajisjeve ARCHITECT ci8200 dhe ARCHITECT i2000SR, ose mallra ekuivalentë, pasi kjo deshmohet lehtesisht nga Autorizimi i Prodhuesit i datës 24.01.2019 i depozituar nga ana jone ne SPE, ku prodhuesi Abbot deklaroi qartësisht se: "ARCHITECT ci8200 dhe ARCHITECT i2000SR jane sisteme te mbyllura qe funksionojnë vetëm dhe ekskluzivisht me reagentë dhe materiale konsumi të Abbot".*

2. Përgjegjësite që u janë ngarkuar Operatorëve ekonomikë në Dokumentat e Tenderit janë ato që lidhen me furnizimin e AK me reagente dhe aksesore të tjerë të nevosjhëm për testimet në laboratorin e agjenteve infektive sipas specifikimeve, kushteve dhe afateve të kërkuara prej AK në DT.

KVO nuk mund të pranojë ofrimin e pajisjeve në përdorim nga OE Medfau dhe OE Swissmed, si kusht për furnizimin e mullrave të kerkuar nga AK. pasi kjo është një përgjegjësi e papërcaktuar në e dokumentat e tenderit. Pra KVO duke e pranuar dicka të tillë ka shkelur nenin 51/2 të LPP që përcakton: "Një ofertuesi si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet ti kërkohej që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentat e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën".

3. KVO nuk mund të marre një vendim që autorizon marrjen në përdorim të një pajisjeje të ndryshme nga ajo që AK disponon si pjesë e inventarit aktual kur dicka e tille nuk është përcaktuar në Urdhërin e Prokurimit dhe ne Dokumentat e Tenderit, pasi do të ishte shkelje Udhëzimit të MF Nr. 30 date 27.12.2011 "Per menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" si dhe e Urdhërit nr. 3272, date 11.09.2007 të Ministrisë të Shëndetësisë "Politikat Kombëtare të Pajisjeve Mjekësore". Se pari Udhëzimi i MF Nr. 30 date 27.12.2011 "Per menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" përcakton se: "35. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në Iibrat e kontabilitetit bazohet ne dokumenta origjinale që përdoren për kete qëllim dhe grupohen në: a) Dokumenta autorizues janë ato dokumenta që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkelidhet dokumentit vertetues. Të tilla janë urdhërat e blerjeve. kontratat, urdhëri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorim itetj.

b) Dokumenta vërtetues vërtetojnë kryerjen ne fakt dhe ne menyre kronologjike të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet. faturat. situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet. Mandat arketimet, mandatpagesat, procesverbalet, dhe te tjera akte me natyre verifikues shpenzimi.

c) Dokumente të kontabilitetit -janë dokumenta! permbledhes ose rregjistrat kontabel (libri i madh. Iibra analitike, kartelat e aktiveve. egi) të cdo lloj forme të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve te kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

36. Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimin, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe te tjera të dhëna te nevojshme që i japin dokumentit forcën e nje prove ligjore ose administrative.

Pra, duket qartë, se në rastin konkret nuk ka një dokument autorizues për marrjen në përdorim ose me dhurim te pajisjeve, por Urdhëri i Prokurimit ka autorizuar vetëm blerjen e materialeve te konsumit për pajisjet që janë efektivisht giendje në QKTGJ.

Së dyti, Urdhëri nr. 3272, datë 11.09.2007 të Ministrisë të Shëndetësisë "Politikat Kombëtare të pajisjeve mjekësore përcakton nder te tjera: "

Në pikën 3.1.5

Procedura e prokurimit të investimeve kapitale në pajisje mjekësore fillon me përshkrimin e nevojave për një pajisje mjekësore dhe mbaron me një test pranimi për të. Skemat e prokurimeve të pajisjeve mjekësore jepen ne figurat 2 dhe 3.

*Kërkesat për pajisje mjekësore duhet të bazohen në nevojat klinike. Procedura e prokurimit mund të ndahet në disa aktivitete të njëpasnjëshme.*

*Nevojat mjekësore nga përdoruesit*

*0 Vendimi nga menaxhuesit*

*Vleresimi i teknologjisë*

*Specifikimet e kërkesave të prodhimit që nevojitet*

*Blerja (Procedura e tenderit)*

*Pranimi i tenderit*

*0 Vendimi nga menaxhuesit*

*Kontraktimi i shitësit/furnizuesit! Të përzgjedhur*

*Dorëzimi dhe instalimi*

*Testi i pranimit dhe kontrolli teknik*

*Përdorimi klinik (Trajnimi i përdoruesve)*

*o Pranimi të raportohet tek menaxhuesi i cili jep lejen për pagese*

*Pagesa nga zyra e finances*

*Garancia*

*Në pikën 3.2*

*Dhurimi i pajisjeve mjekësore është një zgjedhje e dëshiruar nga shumë organizata të kujdesit shëndetësor. Megjithatë dhurimi i pajisjeve mjekësore duhet të jetë në përputhje me të njëjtat politika dhe standarde që zbatohen për prokurimin e pajisjeve të reja mjekësore. Në përgjithësi nuk duhet të ketë dallim nëse pajisja mjekësore është dhuruar apo prokuruar sipas procedurës që përshkruhet në nëndarjen 3.1.*

*Edhe për dhurimet e pajisjeve mjekësore, kuptohet që është e nevojshme të kete procedura që duhen zbatuar gjatë procesit të dhurimit dhe që iu përgjigjen pyetjeve të ndryshme që ngrihen në këtë rast.*

*Kur një marrës pranon një pajisje mjekësore si dhuratë, ai është përgjegjës që pajisja mjekësore të përdoret në mënyrë të sigurtë dhe me efikasitet. Për të qenë të qarta mbi ndikimin ekonomik që një pajisje mjekësore e dhuruar do të ketë në të ardhmen, duhet të bëhet gjithmonë një vlerësim i plotë i kostove të gjithë kohës së përdorimit të pajisjes (kosto e ciklit të jetës).*

*Në pikën 3.4.5*

*Materialet e konsumit dhe aksesorët që janë pjesë e pajisjeve mjekësore dhe duhet të përdoren në kombinim me to, duhet të blihen sipas rekomandimeve të prodhuesit të pajisjes. Vetëm nëse ndiqen rekomandimet e prodhuesit ky i fundit mund të garantojë siguri dhe performancën e pajisjes mjekësore. Blerja e aksesorëve të ndryshëm nga ato të rekomanduara nga prodhuesit duhet të parandalohet.*

*Pra për sa kohë që Urdhëri i Prokurimit dhe Dokumentat e tenderit nuk kanë përcaktuar shprehimisht që objekti i prokurimit përfshin edhe dhënie në përdorim ose dhurimin e pajisjes, kjo nuk mund të pranohet pasi edhe pranimi i dhurimit/marrjes në përdorim duhet të kalojë të njëjtat procedura si blerja me prokurim e pajisjes.*

Nëse AK do të kishte parashikuar edhe pranimin e dhenies ne perdorim te aparaturës, Dokumentat e Tenderit do të ishin ndërtuar si ne proceduren me nr. REF 59375-03-28-2018, me objekt "Blerje kite reagente per testimin me metoden NAT (përfshire venien ne perdorim te aparatit sipas specifikimeve te DST, ku jo vetem është percaktuar ne menyre specifike kerkesa per dhënien ne përdorim të aparaturës. por jane percaktuar edhe kërkesat dhe Specifikimet ne lidhje me të.

Në Dokumental e tenderit, pikën 2.14 te "Njohimit te Kontratës", nga AK është përcaktuar qartë që nuk do te pranohen variantet.

OE Medfau dhe OE Swissmed duke ofruar mallrat e kerkuara të shoqëruara me kushtin e dhenies ne përdorim të pajisjeve te ndryshme nga ato qe disponon AK. te pakërkua nga AK. jane në kushtet e ofertës alternative e cila sipas kushteve të Dokumentave të Tenderit nuk lejohet.

Neni 54 i LPP përcakton që ofertat alternative nuk lejohen, nëse nuk janë autorizuar nga AK.

4.

Përcaktimi i termit "ose ekuivalent" ne Specifikimet Teknike i referohet mallrave te kërkuara nga AK, në rastet kur ato mund te ofrohen nga prodhuesit të ndryshëm nga prodhuesit e paisjeve, por gjithmonë me kusht që produktet e tyre (i) te përputhen me kërkesat e autoritetit kontraktor, (ii) të permbushin te gjithe specifikimet teknike dhe (iii) të jene funksionale për nevojat e AK.

Ne rastin konkret produktet e ofruara nga OE Medfau dhe OE Swissmed nuk i përmbushin këto kushte, pasi prodhuesi i aparaturave ARCHITECT ci8200 dhe ARCHITECT i2000SR në Autorizimin e Prodhuesit te depozituar nga OE Pegasus. sh.p.k., deklararon se këto aparatura janë sisteme të mbyllura që funksionojnë vetëm me aksesoret e ofruar nga ky prodhues.

5.

OE Medfau dhe OE Swissmed, nuk e kanë të drejtën e tregtimit dhe vënies në treg të pajisjeve që kanë ofruar në përdorim dhe as të reagentëve dhe aksesorëve te lidhur me to. Prodhuesi që ne përfaqësojmë, ka ardhur në dijeni se OE Medfau si kusht për funizimin e reagenteve dhe aksesorëve të tjerë, ka ofruar për te dhënë në përdorim ne këtë procedurë prokurimi pajisjet ADVIA Centaur XPT, Dimension EXL200 dhe Immulite 2000 te prodhuesit Siemens Healthcare Diagnostic GmbH, ndërsa OE Swissmed si kusht për fumizimin e reagenteve dhe aksesorëve të tjerë, ka ofruar per të dhënë ne përdorim ne këtë procedure prokurimi pajisjen Cobas 6000 me dy module (e601+c501) të prodhuesit Roche Diagnostics GmbH.

Ligji Nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore", ne nenin 13 përcakton se: "1.Te gjitha pajisjet mjekësore që vendosen në treg ne Republikën e Shqipërisë duhet të regjistronen ne regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore që mbahet nga Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Aplikimi për regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore paraqitet nga: a) prodhuesit e pajisjeve mjekësore që kanë të regjistruar aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, b) përfaqësuesit e prodhuesve të huaj që kanë të regjistruar aktivitetin në Republikën e Shqipërisë; c) tregtuesit me shumicë të pajisjeve mjekësore.

2. AKBPM-ja lëshon një certifikatë per regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombetar të pajisjeve mjekësore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së aplikimit.

Nga konsultimi i Regjistrit të pajisjeve mjekësore në faqen eeb të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (ëëë.akbpm.gov.al/dokumenta/Pajisje Mjekësore.xlsx), na rezultoi se as OE Medfau dhe as OE Swissmed nuk i kanë të regjistruara këto pajisje dhe reagentët përkatës në këtë regjistrë, pra sipas nenit 13 me sipër. nuk e gëzojnë të drejtën e tregtimit të tyre. Më konkretisht:

<i>OE MEDFAU</i>		<i>OE SWISSMED</i>		
<i>Pajisja e ofruar</i>	<i>Pajisje në Regjistrë AKBKPM</i>	<i>Pajisje e ofruar</i>	<i>Pajisje në Regjistrë AKBPM</i>	
<i>Advia Centaur XPT</i>	<i>Advia 360 Hamatology System</i>			
<i>Dimension EXL200</i>	<i>DimensionR RcL Max R</i>	<i>Cobas 600</i>		
<i>Immulite</i>	<i>Immulite R 1000 030006</i>	<i>E601 + c501</i>	<i>ska</i>	

6.

*Në Shtojcën 10 të DT është përcaktuar që kërkohen: "Reagente dhe aksesore të tjera të nevojshme për testimet në Laboratorin e Agjenteve Infektivë për agjentë infektivë dhe bilanc/testime biokimike me analizatorin ARCHITECT ci8200 dhe ARCHITECT i2000SR ose ekuivalent".*

*Sic është shprehur dhe në dokumentat e tenderit kërkohen teste për 2 analizatore: ARCHITECT ci8200 sistemi i integruar dhe ARCHITECT i2000SR analizator. Pra AK ka në pronësi të tij përveç sistemit të integruar ARCHITECT T ci8200 edhe aparatoren ARCHITECT i2000SR që shërben si backup në rast të ndonjë difekti. Në na rezultoi OE Swissmed dhe Medfau nuk kanë ofruar ndonjë pajisje/analizator ekuivalent me ARCHITECT i2000SR që shërben si backup platformën e integruar.*

*Në fakt OE Medfau nuk ka ofruar as pajisje ekuivalent të pajisjes primare (platformës së integruar). Në rast të ndonjë difekti në aparaturë kush do ta mbulojë testimin derisa aparatura e ofruar nga këta operatorë do të rregullohet. Duke qenë që QKTGJ është e vetmja në Shqipëri që teston gjakun, mosfunksionimi dhe për një ditë të vetme për shkak të difekteve do të sillte pasoja shumë të rënda si pasoje e mungesës së testimit të gjakut dhe për shkak të numrit përgjithësisht të vogël të dhurimeve në Shqipëri.*

*B. OE Medfau nuk përmbush Specifikimet Teknike*

*Sic u sqarua me sipër, OE Medfau nuk mundet të pranohet oferta për kitet, reagentët dhe aksesorët e tjerë të kërkuar nga AK, me kushtin e dhënies në përdorim të një pajisjeje që sipas këtij OE mund të jetë "ekuivalente" me platformën ARCHITECT ci8200 dhe i2000SR. Edhe në rast të vlerësimit të "ekuivalencës" së platformës/aparaturave të ofruara nga OE Medfau, përkundrajt pajisjes së integruar ARCHITECT ci8200, sërish specifikimet teknike nuk përmbushen sepse:*

l.

Platforma e ofruar nuk është një platformë e integruar "ekuivalente" me ARCHITECT ci8200 dhe i2000SR. Pajisja ARCHITECT ci8200, është një platform e integruar, tërësisht e automatizuar që do të thote testim ne një mostër të vetme, ne nje pajsije të vetme, ne te niejten kohe, i te gjitha testimeve të kerkuara në DST.

Ne na rezulton se OE Medfau ka ofruar për këte procedurë prokurimi pajisjet ADVIA Centaur XPT, Dimension EXL200 dhe Immulite 2000

Në këto rrethana përkundrejt teknologjisë "vendos mostrën në analizator dhe merr gjithë satin e testimeve të detyrueshme" ofrohet teknologjia e "vendosjes së mostrës në tre analizatorë të ndryshëm per te përfutuar testime të ndryshme", që rezulton larg "ekuivalencës" dhe hap prapa në kohe, eficiencë dhc cilësi testimi, cka do të thotë se nuk kemi të bëjmë me një platformë të integruar ekuivalente të ARCHITECT ci8200. Seicila nga pajisjet e ofruara vec e vec por edhe së bashku, nuk kanë specifikime të njejta/ekuivalente me ato të platformes ARCHITECT. Për ilustrim, duke u referuar ne kataloget perkatës, sjellim krahasimisht vetëm nje pjese te specifikimeve per seicilen pajisje:

Specifikim i Pajisjes	OFRUAR NGA Medfau			ARCHITECT Ci8200
	ADVIA Centaur XPT	Dimension R EXL R Systems	Immulite R XPi	
Kapaciteti Testues	Max 240 teste/ore	Max 794 teste/ore	Max 240 teste/ore	Deri ne 1400 teste/ore
Nr. I reagenteve ne pajisje	Max 30	Max 50	Max 24	Mbi 90
Llojet e mostrave	Serum, Plasma, Urine	Ska info	Serum, Plasma, Urine	Serum, Plasma, Gjak Komplet, Urine
Kapaciteti max i mostrave	180	47	90	365
Kapacitet magazinimi i mostrave	-	33.300	-	50.000

2. Nga shqyrtimi i katalogëve në faqen e prodhuesit Siemens Healthcare Diagnostic GmbH (<https://ëëë.healthcare.Siemens.com/laboratory-diagnostics>), rezulton qartë, se jo vetëm pajisjet e ofruara nga OE Medfau nuk janë ekuivalente me pajisjen e integruar ARCHITECT, por edhe nga kataloget e reagenteve te pajisjeve te ofruara, kuptohet qarte, qe ndryshe nga sa ofrohet në mënyrë të integruar nga platforma ARCHITECT, ne rastin e OE Medfau ofrohet nepermjet 3 pajisjeve të ndryshme: (i) seti i teslimeve imunologjike (agjentë infektivë) Advia Centaur; (ii) testimet biokimike ne pajisjen Dimension EXLZOO; (iii) ndersa CMV ne pajisjen Immulite 2000.

Pra, asnjera nga pajisjet nuk i ofron te gjitha testet njekohesisht sic ben platforma ARCHITECT.



NR	Emërtimi Produktit	OFRUAR			RREGJISTRUAR NË AKBPM		
		Advia Centa ur XPT	Dimensi on R EXL R Systems	Immulate R 2000/2000 XPi	Immulate R 1000 System	Dimensi on R RxL Max R	Advia 360 Hematolo gy System
1.	HBsAg	√		√			
2.	Anti HCV	√					
3.	HIV Ag/Ab (combo)	√					
4.	Sifiliz TP	√		√			
5.	CMV IgG	√		√	√		
6.	CMV IgM	√		√	√		
7.	ALT		√			√	
8.	Ferritin	√	√	√	√	√	
9.	Cholesterol		√			√	
10.	Trigliceride		√			√	
11.	Proteine Total		√			√	
12.	Kreatine mi		√			√	

Ajo cka rezulton nga katalogët e OE Medfau është se grupe reagentësh nga ato të kërkuar në Specifikimet teknike pranohen vetëm nga njëra prej pajisjeve dhe asnjëra prej pajisjeve nuk funksionon me të gjithë reagentët e kërkuar.

Gjithashtu sipas katalogut reagentët HbsAg nuk janë të markuar CE çka është në kundërshtim me pikën 1.3 g të Shtojcës 9 të Dokumentave të Tenderit.

3.

Ne shtojcën 10 “Specifikimete Teknike” te kiteve per agjente infektive jane kërkuar:

- Kitet e testimit ARCHITECT - HBsAg .....
- Kitet e testimit ARCHITECT - anti-HCV .....
- Kitet e testimit ARCHITECT -HIV Ag/Ab combo....
- Kitet e testimit ARCHITECT -Syphilis TP.....,

- *Kitet e testimit ARCHITECT CMV 13M.....*
- *Kitet e testimit ARCHITECT CMV IgG .....*

*Reagentet e ofruar nga OE Medfau nuk jane ARCHITECT sikurse kerkohen qartesisht ne specifikime, por nuk janë as ekuivalentë te tyre, sic provohet nga Autorizimi i Prodhuesit i datës 24.01.2019 i depozituar nga ana jonë ne SPE, ku prodhuesi Abbot deklaroi qartesisht se: 'ARCHITECT ci8200 dhe ARCHITECT i2000SR janë sisteme të mbyllura që funksionojnë vetëm dhe ekskluzivisht me reagentë dhe materiale konsumi të Abbot'.*

4.

*Ne shtojcën 10 "Specifikimet teknike" për kitet për testim biokimike kerkohet që keto të jenë të pershtatshme për ARCHITECT ci 8200 ose ekuivalent. Kitet e ofruara nga OE Medfau nuk janë ARCHITECT sikurse kerkohen qartesisht ne specifikime, por nuk janë as ekuivalentë te tyre, sic provohet nga Autorizimi i Prodhuesit i datës 24.01.2019 i depozituar nga ana jonë në SPE, ku prodhuesi Abbot deklaroi qartesisht se: "Architect ci8200 dhe Architect i2000SR janë sisteme të mbyllura që funksionojnë vetëm dhe ekskluzivisht me reagentë dhe materiale konsumi të Abbot". Gjithashtu sic sqaruar më sipër as pajisjet e ofruara nga OE Medfau nuk janë ekuivalente të platformës Architect ci8200.*

*C. OE Swissmed nuk përmbush Specifikimet Teknike*

*Sic u sqarua më sipër, OE Sëissmed nuk mundet të pranohet oferta për kitet, reagentët dhe aksesoret e tjere të kërkuar nga AK, me kushtin e dhënies në përdorim të një pajisjeje që sipas këtij OE mund të jetë "ekuivalente" me platformën ARCHITECT ci8200 dhe i2000SR. Edhe në rast të vlerësimit të "ekuivalencës" se platformes/aparaturave të ofruara nga OE Swissmed, perkundrejt pajisjes së integruar ARCHITECT ci8200, sërish specifikimet teknike nuk përmbushen sepse:*

*l.*

*Platforma e ofruar nuk është një platformë e integruar "ekuivalente" me ARCHITECT ci8200 dhe i2000SR. Pajisja ARCHITECT ci8200 është një platformë e integruar tërësisht e automatizuar që do të thotë testim në një mostër të vetme, në një pajisje të vetme, në të njëjtën kohë, i të gjitha testeve të kërkuara në DST.*

*Në na rezulton se OE Swissmed ka ofruar si kusht për furnizimin me mallrat e kërkuara nga AK, dhënien në përdorim të pajisjes Cobas 6000 me dy module (e601+c501) të prodhuesit Roche Diagnostics GmbH.*

*Secila nga pajisjet e ofruara, vec e vec por edhe së bashku, nuk kanë specifikime të njëjta/ekuivalente me ato të platformës ARCHITECT.*

*Për ilustrim, duke u referuar në kataloget perkatës, sjellim krahasimisht vetëm një pjesë të specifikimeve për secilën pajisje:*

<i>Specifikim i Pajisjes Kapaciteti Testues</i>	<i>OFRUAR NGA Swissmed</i>	<i>ARCHITECT</i>
	<i>COBAS 6000 (e601 + c501)</i>	<i>Ci8200</i>
	<i>1.170 teste/ore</i>	<i>1400 teste/ore</i>
<i>Nr. I reagenteve ne pajisje</i>	<i>Max 85</i>	<i>Mbi 90</i>
<i>Llojet e mostrave</i>	<i>Serum, Plasma, Urine, CSF</i>	<i>Serum, Plasma, Urine, Gjak Komplet,</i>
<i>Kapaciteti max i mostrave</i>	<i>150</i>	<i>365</i>
<i>Kapacitet magazinimi i mostrave</i>	<i>10.000</i>	<i>50.000</i>

2.

*Në shtojcën 10 "Specifikime Teknike" të kiteve për agjente infektive janë kërkuar:*

- *Kitet e testimit ARCHITECT - HBsAg. ....*
- *Kitet e testimit ARCHITECT – anti – HCV.....*
- *Kitet e testimit ARCHITECT HIV Ag/Ab combo....*
- *Kitet e testimit ARCHITECT Syphilis TP.. .....*
- *Kitet e testimit ARCHITECT CMV IgM..... .....*
- *Kitet e testimit ARCHITECT -CMV IgG .....*

*Reagentet e ofruar nga OE Swissmed nuk janë ARCHITECT sikurse kerkohen qartesisht ne specifikime, por nuk janë as ekuivalentë të tyre, sic provohet nga Autorizimi i Prodhuarit i datës 24.01.2019 i depozituar nga ana jonë në SPE, ku prodhuesi Abbot deklaroi qartësisht se: "ARCHITECT ci8200 dhe ARCHITECT i2000SR janë sisteme të mbyllura që funksionojnë vetëm dhe ekskluzivisht me reagentë dhe materiale konsumi të Abbot".*

3.

*Ne shtojcën 10 "Specifikimet teknike" për kitet për testim biokimik kerkohet që keto të jenë të përshtatshme për ARCHITECT ci8200 ose ekuivalent. Kitet e ofruara nga OE Swissmed nuk janë ARCHITECT sikurse kerkohen qartesisht ne specifikime, por nuk janë as ekuivalentë të tyre, sic provohet nga Autorizimi i Prodhuarit i datës 24.01.2019 i depozituar nga ana jonë në SPE, ku prodhuesi Abbot deklaroi qartësisht se: "ARCHITECT ci8200 dhe ARCHITECT i2000SR janë sisteme të mbyllura që funksionojnë vetëm dhe ekskluzivisht me reagentë dhe materiale konsumi të Abbot". Gjithashtu, sic sqaruam më sipër, as pajisjet e ofruara nga OE Swissmed nuk janë ekuivalente të platformës ARCHITECT ci8200. Gjithashtu na rezultoi se OE Swissmed, ka ofruar reagentët e modulit (e411) për agjentët infektivë, ndërkohë që ky modul nuk rezultoi të jetë pjesë e platformës së integruar Cobas 6000 të ofruar.*

*Në konkluzion: Kerkojme nga AK Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut të shqyrtojë me seriozitet dhe përgjegjshmëri ligjore këtë ankesë tonën dhe:*

1. Te rivlerësojë si të paparanueshme ofertën e OE Medfau, duke e refuzuar atë, bazuar në nenin 53/3 dhe 53/5/c të LPP.

2. Të rivlerësojë si të paparanueshme ofertën e OE Swissmed, duke e refuzuar atë, bazuar në nenin 53/3 dhe 53/5/c të LPP.

Ne rast të mosshqyrtimit me seriozitet e përgjegjshmëri, ne nuk do të reshtim së kërkuari të drejtën tone dhe hetim të thellë të çënimit të kësaj procedure në cdo instancë ligjzbatuese përfshirë edhe platformën e bashkëqeverisjes.

Gjithashtu, sjellim në vëmendjen tuaj se mëyra se si ka vepruar KVO është krejtësisht në shkelje të dispozitave ligjore që rregullojnë barazinë e pjesëmarrjes në tendera, pasi ka ndryshuar rregullat e garës në mes të garës, duke na vendosur në një pozicion të diskriminuar. Kjo mënyrë të vepruari nëse do të vijojë edhe nga KSHA, do të konsiderohet nga ana jonë se përmbush elementet e parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal "Shkelja e barazisë së pjesëmarrjes në tendera ose ankande publike".

II.5. Me shkresën nr. 65/8 prot., datë 25.03.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes duke mos e pranuar ankesën.

Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes së ankesës argumenton se:

[...] –

Në datë 07.03.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e mësipërme të prokurimit. Në datë 12.03.2019 KVO ka mbyllur vlerësimin në sistem ku me shumicë votash i ka kualifikuar të tre operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Në dokumentat e tenderit konkretisht në kriteret e veçanta të kualifikimit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi rezulton se ndër të tjera është kërkuar:

1. Operatori ekonomik duhet të vetdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese,
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë për të gjithë artikujt e lotit për të cilin konkuron, në katalog duhet të markohen artikujt e ofruar,
3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese apo distributorët e autorizuar për tregëtimin e artikujve të ofruar të përkthyer dhe të noterizuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Medfau shpk në përmbushje të kriterëve sa më sipër rezulton se është dorëzuar:

1. Autorizim prodhuesi lëshuar nga prodhuesi Siemens Healthineers të cilët janë përfaqësuesit ligjorë të laboratorit dhe reagentëve, produktet e konsumueshme, datë 18 shkurt 2019 me anë të së cilës autorizohet shoqëria Medfau shpk të dorëzojë dhe të ofrojë pajisjet Advia Centauer XPT, Immulite 2000, Dimensioni EXL 200 dhe reagentët dhe konsumatorë për këto pajisje me qëllim pjesëmarrje në tenderin me objekt blerje reagent dhe aksesore të tjerë të nevojshme për testimin në laboratorin e agjentëve infektivë.
2. Katalogët teknikë për Anti HCV, HIV Ag/Ab (combo), Sifiliz TP, CMV igG, Alt, Ferritin, Cholesterol, Trigliceride, Protein totale, Kreatinemi
3. Deklaratë për origjinën e mallit Datë 07.03.2019.

*Në nenin 46 pika 1 gërma b të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: [...]*

*Në nenin 53[...]*

*Në nenin 27 të VKM 914, datë 29.12.2014[...]*

*Referuar bazës ligjore si më sipër KSHA gjykon se operatori ekonomik Medfau shpk ka dorëzuar dokumentacion në përputhje me kriteret kualifikuese.*

*Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Pegasus shpk se operatori ekonomik Medfau shpk është kualifikuar në këtë procedurë në bazë të një kriteri të pakërkuar, pasi ka ofertuar përveç mallrave objekt prokurimi edhe pajisjet në përdorim, KSHA gjykon se në dokumentat e procedurës së prokurimit, kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike nuk është përjashtuar një mundësi e tillë. Vërtet autoriteti kontraktor ka hartuar specifikimet teknike në varësi të pajisjeve që disponon, por kjo nuk do të thotë që është përjashtuar kategorikisht mundësia që këto pajisje të disponohen dhe ofrohen edhe nga ofertuesit, mjafton që malli i kërkuar të jetë në përputhje me specifikimet teknike të vendosura pavarësisht pajisjeve që do të përdoren për realizimin e testimeve përkatëse.*

*Nga verifikimi i katalogëve të dorëzuar nga operatori ekonomik Medfau shpk rezulton se mallrat objekt prokurimi janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Konkretisht për çdo kit të ofruar janë markuar të gjitha specifikimet teknike të kërkuara të cilat përputhen me ato që ka kërkuar autoriteti në shtojcën 10 të DT.*

*Pretendimi i ankimuesit se pajisjet e ofruara nga ankimuesi nuk kanë specifikime të njëjta/ekuivalente me atë të platformës Architect të tilla si kapaciteti testues të pajisjes, numri i reagentëve, lloji i mostrave, kapaciteti maksimal i mostrave dhe kapaciteti i magazinimit të mostrave, nuk qëndrojnë pasi në DT nuk janë kërkuar specifikime të tilla. Ky krahasim është bërë nga ankimuesi duke ju referuar disa parametrave të cilat nuk janë pjesë e kriterëve dhe as e specifikimeve teknike të kërkuara, dhe nuk mund të konsiderohet shkak për skualifikim të ofertuesit. Për më tepër që pajisjet e ofertuara nga operatori ekonomik Medfau shpk ofrojnë cilësi dhe garanci maksimale për realizimin e kontratës sepse janë të çertifikuara sipas standarteve CE të reja, prodhim i vitit 2018 dhe realizojnë të gjitha testimet e kërkuara nga AK.*

*Fakti që nga ana e operatorit ekonomik Medfau shpk është ofruar edhe mundësia e vënies në dispozicion të pajisjeve nuk mund të jetë një kusht penalizues dhe akoma më tej diskriminues për sa kohë që pajisjet e ofruara mund të realizojnë me efikasitet dhe me saktësi të plotë të gjitha llojet e analizave në përputhje të plotë me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Sikundër cituar edhe më lart nga shqyrtimi i katalogëve të dorëzuar nga operatori ekonomik Medfau shpk, KSHA konstaton se në të rezultojnë të markuara dhe të evidentuara të gjitha elementët që përputhen plotësisht me specifikimet teknike të kërkuara.*

*Gjithashtu sa i takon pretendimit të ankimuesit se pajisjet e ofruara nga operatori ekonomik Medfau shpk nuk realizojnë të gjithë testet e analizave në një platformë të integruar sikundër Architect I2000SR, KSHA sqaron se në dokumentat e procedurës së prokurimit nuk është kërkuar që të gjitha testimet të bëhen në një pajisje të vetme.*

*Pra për sa kohë që pajisjet e ofruara nga operatori Medfau i cili ka ofertuar me vlerën më të ulët, realizojnë qëllimin e kësaj procedure pra kryerjen e testeve me cilësi dhe saktësi, ofrimi i pajisjeve dhe asistenca gjatë ekzekutimit të kontratës nga ana e ofertuesit përbën një avantazh dhe garanci për autoritetin për realizimin me sukses të saj.*

*Lidhur me pretendimin e ankimuesit se reagentët HbsAg nuk janë të markuar CE çka është në kundërshtim me pikën 1.3 g të shtojcës 9 të DT, KSHA sqaron se në pikën e referuar nga ana juaj, nga autoriteti është kërkuar vetëm paraqitja e autodeklaratës nga ana e OE për materialet mjekësore kite, reagent për konformitetin me normat MDD93/42/EC ose 98/34 EC ose 98/79 EC ose CE/DC (deklaratë konformiteti) kur është e aplikueshme sipas direktivave dhe klasifikimit të këshillit të Europës, çka rezulton se është dorëzuar nga ana e OE në përputhje me kriterin. Kompania Medfau shpk ka paraqitur të gjitha çertifikatat CE sipas kërkesës së AK. Ndërsa sa i takon katalogëve të markuar kriter i cili parashikohet në pikën 1.3 c të shtojcës 9 KSHA vëren se në të është kërkuar që katalogët të pasqyrojnë qartësisht specifikimet teknike të mallrave sic edhe është kryer nga OE Medfau shpk.*

*Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se reagentët e ofruar nga shoqëria Medfau shpk nuk janë Architect sikurse kërkohe në specifikimet teknike dhe nuk janë as ekuivalent i tyre, KSHA sqaron se, sikundër u shprehëm dhe më lart operatori Medfau shpk ka paraqitur në procedurën e prokurimit përveç kite dhe reagentë edhe pajisjet që kanë të njëjtin funksion dhe realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me specifikimet teknike. Pra pavarësisht se kitet funksionojnë me pajisjet e vetë operatorit ekonomik AK ka pranuar këtë mënyrë ofertimi pasi qëllimi dhe interesi i autoritetit kontraktor për tu furnizuar me mallra në cilësinë e kërkuar dhe në përputhje me specifikimet teknike është realizuar plotësisht në rastin konkret nga operatori ekonomik Medfau shpk.*

*Sa më sipër KSHA e gjen të pambështetur pretendimin e ankimuesit se autoriteti kontraktor ka shkelur barazinë dhe konkurrencën në klasifikimin dhe përzgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulët. Në këtë kontekst KSHA e gjen të mbështetur qëndrimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik Medfau shpk në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DT. Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.*

II.6. Në datën 01.04.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Medfau” sh.p.k. dhe “Swissmed” sh.p.k.

Konkretisht në ankesën e paraqitur pranë KPP-së operatori ekonomik ankimues argumenton duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

Në lidhje me kthimin e përgjigjes nga autoriteti kontraktor, operatori ekonomik ankimues argumenton se:

*[...] Në datën 25.03.2019 morëm me email nga QSUT përgjigjen për ankesën tonë me nr. 65/8 datë 25.03.2019 ku cilësohet se vendimi i KVO është marrë me shumicë votash. Diçka e tillë u konstatua nga ana jonë edhe në SPE ndaj ne depozituam një kërkesë për informacion nr. 77 datë 13.03.2019 ku kërkuam çdo proces verbal dhe dokument tjetër eventual që mund të jetë mbajtur dhe administruar nga KVO për pasqyrimin e punës së tij në hapjen dhe vlerësimin e ofertave në zbatim të neneve 12 e 21 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.*

*Nga AK na u kthye përgjigje se informacioni i kërkuar nga ana jonë konsiderohet ai që gjendet në sistem në momentin e mbylljes së vlerësimit nga KVO, ndërkohë që ligji e detyron AK, që në bazë të kërkesës sonë të na verë në dispozicion të plota, pikërisht të gjitha të dhënat e kërkuara nga ne në lidhje me vlerësimet dhe komentet mbi to, pasi në SPE ne na shfaqen të dhëna të pjesshme mbi vlerësimet dhe komentet mbi to. Në këto rrethana edhe refuzimi i AK për të na dhënë informacionin e kërkuar përbën shkelje administrative sipas nenit 72 pg1, pikat b dhe c të LPP.*

*Në lidhje me përgjigjen e AK për ankesën tonë me nr.65/8 datë 25.03.2019 sqarojmë se:*

*- për pikat A (1-6) të ankesës sonë AK pretendon si vijon:*

*“Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Pegasus shpk se operatori ekonomik Medfau shpk është kualifikuar në këtë procedurë në bazë të një kriteri të pakërkuar, pasi ka ofertuar përveç mallrave objekt prokurimi edhe pajisjet në përdorim, KSHA gjykon se në dokumentat e procedurës së prokurimit, kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike nuk është përjashtuar një mundësi e tillë. Vërtet autoriteti kontraktor ka hartuar specifikimet teknike në varësi të pajisjeve që disponon, por kjo nuk do të thotë që është përjashtuar kategorikisht mundësia që këto pajisje të disponohen dhe ofrohen edhe nga ofertuesit, mjafton që malli i kërkuar të jetë në përputhje me specifikimet teknike të vendosura pavarësisht pajisjeve që do të përdoren për realizimin e testimeve përkatëse.*

*[...]*

*Fakti që nga ana e operatorit ekonomik Medfau shpk është ofruar edhe mundësia e vënies në dispozicion të pajisjeve nuk mund të jetë një kusht penalizues dhe akoma më tej diskriminues për sa kohë që pajisjet e ofruara mund të realizojnë me efikasitet dhe me saktësi të plotë të gjitha llojet e analizave në përputhje të plotë me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor”.*

*Arsyetimi i mësipërm i KSHA nuk ka asnjë bazë ligjore, ndërkohë që ne kemi listuar një numër aktesh ligjore dhe nënligjore të lidhura me menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe me menaxhimin e pajisjeve mjekësore si aktive, për të argumentuar se nëse AK nuk e ka specifikuar në dokumentat e tenderit mundësinë e ofrimit në përdorim edhe të pajisjes bashkë me kitet, reagentët, kjo nuk mund të pranohet automatikisht nga KVO apo nga KSHA pas faktit pra pas dorëzimit të ofertave. Pra ligji nuk e lejon që pranimi ose jo i fortës nga OE për dhënie në përdorim të pajisjeve si kusht për furnizimin e mallrave të kërkuara, të vendoset nga KVO apo KSHA kur diçka e tillë nuk është vendosur paraprakisht nga strukturat përgjegjëse në AK dhe përcaktuar në Urdhrin e Prokurimit.*

*Gjithashtu duhet theksuar se pikërisht për këtë çështje, OE Swissmed ka paraqitur këtë kërkesë për sqarim më datë 02.03.2019 ku kërkon që AK ti përgjigjet nëse do të lejohet apo jo ofrimi i një pajisje ekuivalente me ato që AK disponon si kusht për ofrimin e kiteve dhe reagentëve. AK nuk ka kthyer përgjigje për këtë kërkesë ndaj supozohet se objekti i procedurës ka qenë i qartë, sepse përndryshe AK do ti kishte kthyer këtij OE të njëjtën përgjigje që na ka dhënë ne më sipër për ankesën tonë. Nëse AK do ta kishte saktësuar diçka të tillë në dokumentat e tenderit edhe ne mund të kishim ofertuar me një formulë tjetër duke ofruar pajisje në përdorim të ndryshme nga ato që AK aktualisht ka, dhe mund të na kishte dalë edhe një çmim më i ulët se ai i OE Medfau.*

- Për pikën B.1 të ankesës sonë KSHA pretendon se:

“Pretendimi i ankimuesit se pajisjet e ofruara nga ankimuesi nuk kanë specifikime të njëjta/ekuivalente me atë të platformës Architect të tilla si kapaciteti testues të pajisjes, numri i reagentëve, lloji i mostrave, kapaciteti maksimal i mostrave dhe kapaciteti i magazinimit të mostrave, nuk qëndrojnë pasi në DT nuk janë kërkuar specifikime të tilla. Ky krahasim është bërë nga ankimuesi duke ju referuar disa parametrave të cilat nuk janë pjesë e kritereve dhe as e specifikimeve teknike të kërkuara, dhe nuk mund të konsiderohet shkak për skualifikim të ofertuesit. Për më tepër që pajisjet e ofertuara nga operatori ekonomik Medfau shpk ofrojnë cilësi dhe garanci maksimale për realizimin e kontratës sepse janë të certifikuara sipas standarteve CE të reja, prodhim i vitit 2018 dhe realizojnë të gjitha testimet e kërkuara nga AK.....

.....Gjithashtu sa i takon pretendimit të ankimuesit se pajisjet e ofruara nga operatori ekonomik Medfau shpk nuk realizojnë të gjithë testet e analizave në një platformë të integruar sikundër Architect I2000SR, KSHA sqaron se në dokumentat e procedurës së prokurimit nuk është kërkuar që të gjitha testimet të bëhen në një pajisje të vetme. Pra për sa kohë që pajisjet e ofruara nga operatori Medfau i cili ka ofertuar me vlerën më të ulët, realizojnë qëllimin e kësaj procedure pra kryerjen e testeve me cilësi dhe saktësi, ofrimi i pajisjeve dhe asistenca gjatë ekzekutimit të kontratës nga ana e ofertuesit përbën një avantazh dhe garanci për autoritetin për realizimin me sukses të saj”.

Përgjigja e mësipërme e KSHA është thjesht një tentativë për tu shmangur nga thelbi i argumentit tonë ë edhe në rast se do të merrnim të mirëqenë pretendimin e AK se terimi “ekuivalent” ka të bëjë edhe pajisjet dhe jo vetëm me mallrat (kitet, reagentët) e kërkuar për tu prokuruar, sërish platforma e aparaturave të ofruara nga OE Medfau nuk është ekuivalente e platformës ARCHITECT ci8200 dhe ARCHITECT i2000SR. Siç kemi sqaruar në pikën B.1 (të ankesës sonë), ARCHITECT ci8200 luan rolin e pajisjes së integruar (diçka e tillë nuk është ofruar nga Medfau) dhe në pikën A. 6 kemi sqaruar se ARCHITECT i2000SR luan rolin e pajisjes back up (sërish diçka e tillë nuk është ofruar nga Medfau).

- Për pikën B.2 të ankesës sonë KSHA pretendon se:

“Lidhur me pretendimin e ankimuesit se reagentët HbsAg nuk janë të markuar CE çka është në kundërshtim me pikën 1.3 g të shtojcës 9 të DT, KSHA sqaron se në pikën e referuar nga ana juaj, nga autoriteti është kërkuar vetëm paraqitja e autodeklaratës nga ana e OE për materialet mjekësore kite, reagent për konformitetin me normat MDD93/42/EC ose 98/34 EC ose 98/79 EC ose CE/DC (deklaratë konformiteti) kur është e aplikueshme sipas direktivave dhe klasifikimit të këshillit të Europës, çka rezulton se është dorëzuar nga ana e OE në përputhje me kriterin. Kompania Medfau shpk ka paraqitur të gjitha certifikatat CE sipas kërkesës së AK.....”.

Në ankesën tonë ne i kemi referuar katalogëve zyrtarë të publikuar nga kompania prodhuese në faqen e vet të internetit. Fakti që OE ka paraqitur një autodeklaratë që cilëson diçka të ndryshme, duhet, thjesht të ishte shkak për AK që të dyshonte në vërtetësinë e kësaj autodeklarate, në kushtet e mospërputhjes me informacionin e publikuar nga vetë prodhuesi në faqen e vet zyrtare.



- Lidhur me pikën B. 3 dhe B. 4 të ankesës sonë, KSHA pretendon se:

“Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes se reagentët e ofruar nga shoqëria Medfau shpk nuk janë Architect sikurse kërkohen në specifikimet teknike dhe nuk janë as ekuivalent i tyre, KSHA sqaron se, sikundër u shprehëm dhe më lart operatori Medfau shpk ka paraqitur në procedurën e prokurimit përveç kite dhe reagentë edhe pajisjet që kanë të njëjtin funksion dhe realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me specifikimet teknike. Pra pavarësisht se kitet funksionojnë me pajisjet e vetë operatorit ekonomik AK ka pranuar këtë mënyrë ofertimi pasi qëllimi dhe interesi i autoritetit kontraktor për tu furnizuar me mallra në cilësinë e kërkuar dhe në përputhje me specifikimet teknike është realizuar plotësisht në rastin konkret nga operatori ekonomik Medfau shpk”.

Edhe në këtë qëndrim të vetin AK në mënyrë absurde pretendon se në mes të garës pasi janë dorëzuar ofertat mund ti japë të drejtën vetes të modifikojë objektin dhe natyrën e prokurimit dhe dokumentat e tenderit, dhe se mundet me inisiativë të pranojë nga OE një mënyrë ofertimi krejtësisht të ndryshme nga ajo që ka vendosur në Urdhërin e Prokurimit dhe njoftuar në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret objekti i prokurimit është i qartë dhe i plotë “Blerje kite, reagentë ....” dhe AK nuk ka publikuar ndonjë objekt prokurimi që ka të bëjë me ofrimin e shërbimit të analizave psh ku OE mund tu lihej hapësirë për të gjetur vetë zgjidhjet teknike për platformat / aparaturat eventuale.

- Lidhur me pikën C të ankesës sonë, KSHA nuk ka mbajtur asnjë qëndrim.

II.7. Në datën 03.04.2019, nëpërmjet shkresës me nr.93 prot., datë 02.04.2019, me objekt: “Informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Pegasus” sh.p.k.

Nga dokumentacioni dhe informacioni i autoritetit kontraktor konstatohet se:

[...]

Përsa i përket shqyrtimit të ofertave të paraqitura nga OE Medfau dhe Swissmed, anëtarët e KVO I.S (Kryetare) dhe S.XH. vlerësuar dhe vendosën si më poshtë:

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga shoqëria Medfau nuk plotësonte sa më poshtë:

Në aspektin ligjor:

Oferta nuk është e vlefshme në kuptim të nenit 53/3 të LPP që përcakton se: [...]

Në mënyrë të detajuar:

- a. Njoftimi i kontratës dhe DST kanë përcaktuar që objekti i kontratës është “Blerje reagente dhe aksesori të tjerë të nevojshëm për testimet në laboratorin e agjenteve infektive”. OE Medfau ndryshe nga sa është përcaktuar nga AK ka ofruar mallrat e kërkuara nga AK dhe dhënie në përdorim të pajisjes çka del jashtë objektit të përcaktuar nga vetë AK në DST.

- b. *Ofrimi i pajisjes në përdorim nga OE Medfau nuk mund të kërkohej dhe as të pranohet nga ne si anëtarë të KVO pasi kjo është një përgjegjësi e papërcaktuar në dokumentat e tenderit ndaj KVO nëse do ta pranonte diçka të tillë do shkelte nenin 51/2 të LPP që përcakton se: “Një ofertuesi si kusht për shpalljen fitues nuk duhet t’i kërkohej që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentat e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdo mënyre ofertën”.*
- c. *Në dokumentat e tenderit pikën 2.14 të “Njoftimit të kontratës” nga AK është përcaktuar qartë që nuk do të pranohen variantet. OE Medfau duke ofruar mallrat e kërkuara të shoqëruara me dhënien në përdorim të pajisjes, të pakërkuar nga AK, janë në kushtet e ofertës alternative e cila sipas kushteve të DT nuk lejohet. Neni 54 i LPP përcakton që ofertat alternative nuk lejohen, nëse nuk janë autorizuar nga AK.*
- d. *Marrja në përdorim e një pajisjeje të ndryshme nga ajo që AK disponon nuk mund të realizohet kur nuk është përcaktuar në Urdhërin e Prokurimit dhe në DT pasi do të ishte shkelje e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.*
- e. *Urdhri i Prokurimit dhe DT nuk kanë përcaktuar shprehimisht që objekti i prokurimit përfshin edhe dhënien në përdorim ose dhurimin e pajisjes ndaj kjo nuk mund të pranohet pasi do të ishte në kundërshtim edhe me “Politikat Kombëtare të Pajisjeve Mjekësore” miratuar me Urdhrin nr. 3272, datë 11.09.2007 të Ministrit të Shëndetësisë konkretisht pikën 3.2 që përcakton se edhe pranimi i dhurimit / marrjes në përdorim duhet të kalojë të njëjtat procedura si blerja me prokurim e pajisjes.*
- f. *Përcaktimi i termit “ose ekuivalent” në Specifikimet teknike i referohet mallrave të kërkuara nga AK në rastet kur ato mund të ofrohen nga prodhues të ndryshëm nga prodhuesit e pajisjeve, por gjithmonë me kusht që produktet e tyre (i) të përputhen me kërkesat e autoritetit kontraktor, (ii) të përmbushin të gjithë specifikimet teknike dhe (iii) të jenë funksionale për nevojat e AK. Në rastin konkret produktet e ofruara nga OE Medfau nuk i përmbushin këto kushte, pasi ne si anëtarë të KVO konstatojmë se prodhuesi i aparaturave ARCHITECT ci8200 dhe ARCHITECT i2000SR në Autorizimin e Prodhuesit të depozituar nga OE Pegasus shpk deklaroi se këto aparatura janë sisteme të mbyllura që funksionojnë vetëm me aksesoret e ofruar nga ky prodhues.*

*Nëse AK do të kishte parashikuar edhe pranimin e dhënies në përdorim të aparaturës, DT do të ishin ndërtuar si në procedurën me nr. REF59375-03-28-2018, me objekt “Blerje kite reagentë për testimin me metodën NAT (përfshirë vënien në përdorim të aparatit sipas specifikimeve të DST)”, ku jo vetëm është përcaktuar në mënyrë specifike kërkesa për dhënien në përdorim të aparaturës por janë përcaktuar edhe kërkesat dhe specifikimet në lidhje me të.*

## *Në aspektin teknik*

*Edhe pse baza e mësipërme ligjore nuk le shteg për ofertë pajisjesh në një procedurë prokurimi për reagentë dhe aksesorë, dhe për pasojë çon në skualifikimin e OE Medfau ne kemi bërë vlerësimin teknik të ofertës së këtij OE e cila edhe sikur të ishte parë në këndvështrimin teknik të përmbushjes së kriterëve (pra jashtë premisave ligjore të listara më sipër) nuk do të mund të kualifikohet. Më poshtë po paraqesim detajet dhe arësytimin që na çon në këtë përfundim.*

*Pajisja ARCHITECT ci8200 është një platformë e integruar me kapacitet të lartë tërësisht e automatizuar që do të thotë testim në një mostër të vetme në një pajisje të vetme në të njëjtën kohë i të gjitha testeve të kërkuara në DST. Pikërisht ndaj platformës së integruar ARCHITECT ci8200 ne na duhet të gjykojmë mbi “ekuivalencën”.*

- *OE Medfau nuk ka ofruar një platformë të integruar “ekuivalente” me ARCHITECT ci8200 dhe i2000SR*

*Në deklaratën e OE Medfau për përmbushjen e specifikimeve teknike si edhe në Autorizimin e Prodhuesit të kompanisë Siemens Healthcare Diagnostic GmbH për OE Medfau thuhet se “pajisjet e ofruara nga OE Medfau për këtë procedurë prokurimi janë, Advia Centaur XPT, Dimension EXL200 dhe Immulite 2000. Pra që këtu kuptojmë që nuk kemi të bëjmë me një platformë të integruar ekuivalente të ARCHITECT ci8200. Kjo del qartë edhe nga katalogët e vënë në dispozicion të KVO nga Medfau ku kemi të markuara në këto katalogë setin e testeve imunologjike (agjentë infektivë) në katalogun e pajisjes Advia Centaur CP, testeve biokimike në pajisjen Dimension EXL200 dhe CMV në katalogun e pajisjes Immulite 2000.*

*Pra përkundrejt teknologjisë “vendos mostrën në analizator dhe merr gjithë setin e testeve të detyrueshme” ofrohet teknologjia e “vendosjes së mostrës në tre analizatorë të ndryshëm për të përfutur teste të ndryshme”, që rezulton larg “ekuivalencës” dhe hap prapa në kohë, eficiencë dhe cilësi testi.*

- *Ne Kriteret e Vecanta të Kualifikimit pika 2.3c “kërkohen kataloge teknike për të gjithë artikujt e loteve për të cilat konkurohet. Ne kataloge duhet të markohen me ngjyre të ndezur artikujt e ofruar”.*

*Informacioni që na jepet nga katalogët e OE Medfau rezulton i paqarte dhe kontradiktor. Reagentet e markuar sipas kësaj kerkese i takojnë një pajisje të ndryshme nga ajo e përmendur në Autorizimin e Prodhuesit dhe në vetdeklarimin e OE Medfau, ashtu sikurse edhe katalogët e reagentëve të testimit për agjente infektive paraqesin pershtatshmeri për pajisje të ndryshme duke na prodhuar konfuzion në gjykim lidhur me reagentet që ofrohen në këtë procedurë.*

- *Ne shtojcën 10 “Specifikime Teknike” të kësaj për agjente infektive kërkohen:*

- 1. Kitet e testimit ARCHITECT – HBsAg.....*
- 2. Kitet e testimit ARCHITECT – anti-HCV.....*

3. Kitet e testimit ARCHITECT – HIV Ag/Ab combo....
4. Kitet e testimit ARCHITECT – Syphilis TP.....
5. Kitet e testimit ARCHITECT – CMV IgM.....
6. Kitet e testimit ARCHITECT – CMV IgG.....

*Pra kemi nje kerkese te qarte per reagente ARCHITECT. Reagentet e ofruar nga OE Medfau nuk jane ARCHITECT sikurse kerkohen qartesisht ne specifikime.*

- *Po ne shtojcen 10 per Specifikimet teknike te kiteve per testime biokimike kerkohet qe keto kite te jene te pershtatshme per ARCHITECT ci8200 ose ekuivalent.*

*Kitet biokimike te ofruara nga OE Medfau nuk rezultojne te jene te pershtatshme as per ARCHITECT ci8200 dhe as per nje pajisje ekuivalente te saj.*

*Për më tepër nga këqyrja e parametrave të performacës së kite/reagentëve për testimin për agjentë infektivë të OE Medfau, me qellim gjykimin mbi ekuivalencën, vërejmë se mungon informacioni për performancën e reagentëve mbi mostrat në seroconversion duke bërë të pamundur gjykimin e ekuivalencës në performancën e reagentëve lidhur me një çështje thelbësore për sigurinë e gjakut sikurse është serokonversioni (momenti kur dhuruesi nga negativ bëhet pozitiv për një infektion të caktuar). Po kështu nuk gjykojmë dot për ekuivalencën e reagentëve për testimin HbsAg dhe HIVAg pasi në (katalogët e kiteve) “package insert” të OE Medfau mungon një e dhënë mjaft e rëndësishme për reagentin sikurse është SENSITIVITETI ANALITIK, kriter ky gjithmonë i pranishëm në specifikimet tona teknike i hequr këtë vit. Po kështu në “package insert” të reagentëve për testimin Syphilis mungojnë totalisht të dhënat për dhuruesit e gjakut duke bërë të pamundur gjykimin mbi ekuivalencën.*

*Përsa i takon reagentëve të ofruara nga OE Medfau për testimin CMV mund të thuhet se mungojnë totalisht të dhënat e ndjeshmërisë e specificitetit në dhuruesit e gjakut si për atë IgG ashtu edhe për atë IgM, ndërkohë që për këtë të fundit rezulton se nuk ka të dhëna fare për ndjeshmërinë as atë në serokonversion si dhe nuk përmendet fare specificiteti. Nuk mund të lemë pa përmendur këtu ndryshimin në shtojcën 10 të DST për specifikimet teknike të kiteve CMV IgM të këtij viti (2019) ku është kërkuar një kit me një performancë shumë më të dobët duke ulur specificitetin nga 99.5% në 92% dhe për CMV IgG nga 99% në 96%.*

*Në fund por jo për nga rëndësia nuk kemi arritur të kuptojmë nga këqyrja e dokumentacionit të këtij OE mënyrën se si do të organizohet back up në testimin për agjentë infektivë (asnjë laborator testimi për agjentë infektivë nuk mund të funksionojë pa back-up).*

*Bazuar në sa më sipër vendosëm skualifikimin e ofertës së shoqërisë Medfau shpk.*

2. *Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga shoqëria Swissmed nuk plotësonte sa më poshtë:*

*Oferta nuk është e vlefshme në kuptim të nenit 53/3 të LPP që përcakton se: [...]*

*Në mënyrë të detajuar:*

- a. *Njoftimi i kontratës dhe DST kanë përcaktuar që objekti i kontratës është “Blerje reagente dhe aksesori të tjerë të nevojshëm për testimet në laboratorin e agjenteve infektive”. OE Swissmed ndryshe nga sa është përcaktuar nga AK ka ofruar mallrat e kërkuara nga AK dhe dhënie në përdorim të pajisjes çka del jashtë objektit të përcaktuar nga vetë AK në DST.*
- b. *Ofrimi i pajisjes në përdorim nga OE Swissmed nuk mund të kërkohej dhe as të pranohet nga ne si anëtarë të KVO pasi kjo është një përgjegjësi e papërcaktuar në dokumentat e tenderit ndaj KVO nëse do ta pranonte diçka të tillë do shkelte nenin 51/2 të LPP që përcakton se: “Një ofertuesi si kusht për shpalljen fitues nuk duhet t’i kërkohej që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentat e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdo mënyre ofertën”.*
- c. *Në dokumentat e tenderit pikën 2.14 të “Njoftimit të kontratës” nga AK është përcaktuar qartë që nuk do të pranohen variantet. OE Swissmed duke ofruar mallrat e kërkuara të shoqëruara me dhënien në përdorim të pajisjes, të pakërkuar nga AK, janë në kushtet e ofertës alternative e cila sipas kushteve të DT nuk lejohet. Neni 54 i LPP përcakton që ofertat alternative nuk lejohen, nëse nuk janë autorizuar nga AK.*
- d. *Marrja në përdorim e një pajisjeje të ndryshme nga ajo që AK disponon nuk mund të realizohet kur nuk është përcaktuar në Urdhërin e Prokurimit dhe në DT pasi do të ishte shkelje e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.*
- e. *Urdhri i Prokurimit dhe DT nuk kanë përcaktuar shprehimisht që objekti i prokurimit përfshin edhe dhënien në përdorim ose dhurimin e pajisjes ndaj kjo nuk mund të pranohet pasi do të ishte në kundërshtim edhe me “Politikat Kombëtare të Pajisjeve Mjekësore” miratuar me Urdhërin nr. 3272, datë 11.09.2007 të Ministrisë të Shëndetësisë konkretisht pikën 3.2 që përcakton se edhe pranimi i dhurimit / marrjes në përdorim duhet të kalojë të njëjtat procedura si blerja me prokurim e pajisjes.*
- f. *Përcaktimi i termit “ose ekuivalent” në Specifikimet teknike i referohet mallrave të kërkuara nga AK në rastet kur ato mund të ofrohen nga prodhues të ndryshëm nga prodhuesit e pajisjeve, por gjithmonë me kusht që produktet e tyre (i) të përputhen me kërkesat e autoritetit kontraktor, (ii) të përmbushin të gjithë specifikimet teknike dhe (iii) të jenë funksionale për nevojat e AK. Në rastin konkret produktet e ofruara nga OE Medfau nuk i përmbushin këto kushte, pasi ne si anëtarë të KVO konstatojmë se prodhuesi i aparaturave ARCHITECT ci8200 dhe ARCHITECT i2000SR në Autorizimin e Prodhuesit të depozituar nga OE Pegasus shpk deklaroi se këto aparatura janë sisteme të mbyllura që funksionojnë vetëm me aksesori të ofruar nga ky prodhues.*

*Nëse AK do të kishte parashikuar edhe pranimin e dhënies në përdorim të aparaturës, DT do të ishin ndërtuar si në procedurën me nr. REF59375-03-28-2018, me objekt “Blerje kite reagentë për testimin me metodën NAT (përfshirë vënien në përdorim të aparatit sipas specifikimeve të DST)”, ku jo vetëm është përcaktuar në mënyrë specifike kërkesa për dhënien në përdorim të aparaturës por janë përcaktuar edhe kërkesat dhe specifikimet në lidhje me të.*

*Në aspektin teknik*

*Edhe pse baza e mësipërme ligjore nuk le shteg për ofertë pajisjesh në një procedurë prokurimi për reagentë dhe aksesorë, dhe për pasojë çon në skualifikimin e OE Swissmed ne kemi bërë vlerësimin teknik të ofertës së këtij OE e cila edhe sikur të ishte parë në këndvështrimin teknik të përmbushjes së kriterëve (pra jashtë premisave ligjore të listara më sipër) nuk do të mund të kualifikohej. Më poshtë po paraqesim detajet dhe arësyetimin që na çon në këtë përfundim.*

- *Nga deklarata e sigurisë e garancisë si edhe nga vetëdeklarimi për përmbushjen e specifikimeve teknike kuptojme se ofrohet pajisja Cobas 6000 me dy module (e601+c501), ndërkohë që në katalogë janë markuar për agjentët infektivë reagentët e modulit e 411, i cili nuk rezulton të jetë pjesë e platformës së integruar Cobas 6000 të ofruar.*
- *Kriteret e Vecanta te Kualifikimit pika 2.3 c kerkojne qartesisht qe OE te paraqese kataloget teknike per te gjithë artikujt e lotit per te cilin konkuron. Nga shqyrtimi i dokumentacionit te OE Swissmed nuk gjejme asnje prej katalogeve te performances se kiteve te testimit te ofruara per HBsAg, anti-HCV, HIVAg/Ab, Syphilis, CMV IgG+IgM, si edhe ato biokimike. Mungesa e ketij informacioni konsiderohet si mosperputhje e te gjitha specifikimeve teknike te kiteve pasi KVO nuk mund te gjykoje per to.*
- *Ne shtojcen 10 “Specifikime Teknike” te kiteve per agjente infective kerkohen:*
  1. *Kitet e testimit ARCHITECT – HBsAg.....*
  2. *Kitet e testimit ARCHITECT – anti-HCV.....*
  3. *Kitet e testimit ARCHITECT – HIV Ag/Ab combo....*
  4. *Kitet e testimit ARCHITECT – Syphilis TP.....*
  5. *Kitet e testimit ARCHITECT – CMV IgM.....*
  6. *Kitet e testimit ARCHITECT – CMV IgG.....*

*Pra kemi nje kerkese te qarte per reagente ARCHITECT. Reagentet e ofruar nga OE Swissmed nuk jane ARCHITECT sikurse kerkohen qartesisht ne specifikime.*

*Bazuar sa më sipër vendosëm skualifikimin e ofertës së shoqërisë Swissmed shpk.*

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

## Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Medfau”sh.p.k. për arsye se : “OE Medfau ka ofruar mallrat e kërkuara nga AK (reagentë dhe aksesore) me kushtin e dhënies në përdorim prej tyre të pajisjes/pajisjeve të ndryshme nga ARCHITECT ci8200 dhe ARCHITECT i2000SR.

Njoftimi i Kontratës dhe Dokumentat e Tenderit (DT), që hartohen bazuar në Urdherin e Prokurimit përkatës, kanë përcaktuar që objekti i kontratës është "Blerje Reagente, dhe aksesore te tjere re nevojshem per testimet ne laboratorin e agjenteve infektive".

Pra, na rezulton, se dhenia në përdorim e pajisjes/pajisjeve, është një element që nuk është kërkuar nga AK në Dokumentat e Tenderit, cka del jashtë objektit të përcaktuar nga vetë AK në Urdherin e Prokurimit dhe DT.

OE Medfau, e ka objektivisht të pamundur të ofrojne reagentë dhe aksesore të tjerë nga prodhuesit e pajisjeve ARCHITECT ci8200 dhe ARCHITECT i2000SR, ose mallra ekuivalentë, pasi kjo deshmohet lehtësisht nga Autorizimi i Prodhuesit i datës 24.01.2019 i depozituar nga ana jone ne SPE, ku prodhuesi Abbot deklaroi qartësisht se: "ARCHITECT ci8200 dhe ARCHITECT i2000SR jane sisteme te mbyllura qe funksionojnë vetëm dhe ekskluzivisht me reagentë dhe materiale konsumi të Abbot".

2. Përgjegjësite që u janë ngarkuar Operatorëve ekonomikë në Dokumentat e Tenderit janë ato që lidhen me furnizimin e AK me reagente dhe aksesore të tjerë të nevojshëm për testimet në laboratorin e agjenteve infektive sipas specifikimeve, kushteve dhe afateve të kërkuara prej AK në DT.

KVO nuk mund të pranojë ofrimin e pajisjeve në përdorim nga OE Medfau, si kusht për furnizimin e mullrave të kërkuar nga AK, pasi kjo është një përgjegjësi e papërcaktuar në dokumentat e tenderit. Pra KVO duke e pranuar dicka të tillë ka shkelur nenin 51/2 të LPP që përcakton: "Një ofertuesi si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet të kërkojë që të ndërmerë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentat e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdo mënyre ofertën", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, pika I.2.2 “Njoftimi i kontratës”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.2 Lloji i “Kontratave Publike për Mallra”

Blerje	Qira	Leasing	Blerje me këste	Një kombinim i tyre
X	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

III.1.2. Në dokumentat e tenderit, pika I.2.8.4 “Njoftimi i kontratës”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër “Blerje reagentë, dhe aksesore te tjere te nevojshem etj. për Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut”, ndarë në 2 Lote.

Lot. I “Blerje Reagente, dhe aksesore te tjere te nevojshem per testimet ne laboratorin e agjenteve infektive”

Lot.II“Reagente dhe aksesore te tjere te nevojshem per testimet ne laboratorin e Imunohematologjise”.

Ndërsa në pikën 2.14 është përcaktuar:

Do të pranohen variantet:

Po  Jo

III.1.3. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10 Specifikimet teknike, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar si më poshtë:

“LOT. 1 REAGENTE DHE AKSESORE TE TJERE TE NEVOJSHEM PER TESTIMET NE LABORATORIN E AGJENTEVE INFEKTIVE.

Reagente dhe aksesore te tjere te nevojshem per testimet ne Laboratorin e Agjenteve Infektive per agjente infektive dhe bilanc/testime biokimike me analizatorin ARCHITECT ci8200 dhe ARCHITECT i2000SR ose ekuivalent.

Nr. Rendor	Emri i produktit	Njesia	Sasia
1	HBsAg	teste	36 000
2	Anti HCV	teste	34 000
3	HIV Ag/Ab (combo)	teste	34 000
4	Sifiliz TP	teste	34 000
5	CMV IgG	teste	100
6	CMV IgM	teste	100
7	ALT	teste	34 000
8	Ferritin	teste	10 000
9	Cholesterol	teste	10 000
10	Trigliceride	teste	10 000
11	Proteine Total	teste	10 000
12	Kreatinemi	teste	10 000



## **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Specifikimet teknike te kiteve per agjentet infektive jane si me poshte:**

### **Të përgjithshme**

- 1- Kitet duhet te jene te pershtatshem per perdorim me aparaturen plotesisht automatike, testime per agjente infektive dhe ato biokimike, ne ARCHITECHT **ci8200** dhe ARCHITECHT **i2000SR** (ato imunologjike) ose ekuivalente.
- 2- Afati i skadences per **kitet e testimeve per agjentet infektive** (mikroparticelat, konjugatin, kalibratoret e diluentin) dhe **per testimet biokimike** te jete te pakten **mbi 4 muaj** nga data e marjes ne dorezim (levrimet te tyre).
- 3- Afati i skadences per te gjithë reagentet dhe aksesoret e tjere si: sol. Tretese (Pre-trigger sol dhe trigger sol) dhe sol. Shpelaresh (bufferat), te jete **mbi 6 muaj** nga koha e marjes ne dorezim.
- 4- Gjithë itenerari i transportit deri ne marjen ne dorezim te seteve te perbere nga sa me siper (kite reagentesh, kalibratore dhe kontrolle) duhet te behet ne kushte temperature te monitoruar (2-8°C) e ne pozicionin vertikal.
- 5- Brenda kesaj vlere te perfshihet edhe mirembajtja e aparaturave (**ARCHITECT ci8200** dhe **ARCHITECT i2000SR**) ose ekuivalente.

### **Kitet e testimit per HBsAg.**

1. Kitet e testimit ARCHITECT – HBsAg, jane imunoassay me microparticela kemiluminishente per detektimin kualitativ te antigenit siperfaqesor te hepatitit B ne plazmen dhe serumin human.
2. Kitet duhet të kenë një specificitet mbi 99.91% dhe një sensitivitet 100%.
3. Sasia e kerkuar eshte bashkangjitur

### **Kitet e testimit per anti- HCV.**

1. Kitet e testimit ARCHITECT – anti-HCV, jane imunoassay me microparticela kemiluminishente per detektimin kualitativ te antikorpeve te hepatitit C ne plazmen dhe serumin human.
2. Kitet duhet të kenë një specificitet te pergjithshem 99.60% dhe një sensitivitet jo me pak se 99.10%.
3. Sasia e kerkuar eshte bashkangjitur.

### **Kitet e testimit per HIV Ag/Ab combo**

1. Kitet e testimit ARCHITECT – HIV Ag/Ab combo, jane imunoassay me microparticela kemiluminishente per detektimin kualitativ te njekoheshem, te antigenit HIV p24 dhe antikorpeve te viruseve te imunodeficiencies humane te tipit1 dhe/ose te tipit 2 ne plazmen dhe serumin human.
2. Kitet duhet të kenë një specificitet mbi 99.5% dhe një sensitivitet 100%.
3. Sasia e kerkuar eshte bashkangjitur.

### **Kitet e testimit per Sifiliz**

1. Kitet e testimit ARCHITECT – Syphilis TP, jane imunoassay me microparticela kemiluminishente per detektimin kualitativ te antikorpeve te Treponema Pallidium (TP) ne plazmen dhe serumin human.

2. Kitet duhet të kenë një specificitet jo më të vogël se 99.00% dhe një sensitivitet 100%.
3. Sasia e kerkuar është bashkangjitur.

#### **Kitet e testimit per CMV (IgM)**

1. Kitet e testimit ARCHITECT – CMV IgM, janë imunoassay me microparticela kemiluminishente per detektimin kualitativ te antikorpeve (IgM) te Citomegalovirusit ne plazmen dhe serum human.
2. Kitet duhet të kenë një specificitet jo më të vogël se 92%.
3. Sasia e kerkuar është bashkangjitur.

#### **Kitet e testimit per CMV (IgG)**

1. Kitet e testimit ARCHITECT – CMV IgG, janë imunoassay me microparticela kemiluminishente per detektimin kualitativ te antikorpeve (IgG) te Citomegalovirusit ne plazmen dhe serum human.
2. Kitet duhet të kenë një specificitet jo më të vogël se 96.00%.
3. Sasia e kerkuar është bashkangjitur.

#### **Specifikimet teknike të kитеve për testimet biokimike të jenë si më poshtë:**

Kitet duhet te jene te pershtatshme per perdorim me aparaturen plotesisht automatike ARCHITECHT ci8200 ose ekuivalent.

#### **ALT/GPT**

- Kitet duhet te jene te pershtatshem per percaktimin sasior te nivelit te alanine amino-transferazes (ALT/GPT) ne plasmen dhe/apo serum human, nepermjet aparatures apo sistemit ARCHITECHT ci8200 ose ekuivalent

#### **Ferritine**

- Kitet duhet te jene te pershtatshem per percaktimin sasior te nivelit te ferritines ne plasmen dhe/apo serum human, nepermjet aparatures/sistemit ARCHITECHT ci8200 ose ekuivalent.

#### **Cholesterol**

- Kitet duhet te jene te pershtatshem per percaktimin sasior te nivelit te kolesterolit ne plasmen dhe/apo serum human, nepermjet aparatures/sistemit ARCHITECHT ci8200 ose ekuivalent.

#### **Trigliceride**

- Kitet duhet te jene te pershtatshem per percaktimin sasior te nivelit te triglicerideve ne plasmen dhe/apo serum human, nepermjet aparatures/sistemit ARCHITECHT ci8200 ose ekuivalent.

#### **Proteina totale**

- Kitet duhet te jene te pershtatshem per percaktimin sasior te nivelit te proteinave totale ne plasmen dhe/apo serum human.

#### **Creatinina**

- Kitet duhet te jene te pershtatshem per percaktimin sasior te nivelit te kreatinines ne plasmen dhe/apo serum human.

**Afatet e lëvrimit: Sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor**

**Duke filluar menjehere pas lidhjes se Marreveshjes Kuader me afat 12 (dymbedhjete) muaj**

III.1.4. Në nenin 1 “Objekti dhe Qëllimi” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.
2. Qëllimi i këtij ligji është:
  - a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
  - b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
  - c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
  - ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
  - d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
  - dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.5. Në nenin 20 “Mosdiskriminimi” të ligjit nr. 964, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”.

III.1.6. Në nenin 23 pika 1, 2, “Specifikimet teknike” të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

III.1.7. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” i ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.1.8. Në nenin 27, pikat 1, 2, 3 dhe 6 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1.Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

2. Autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë si dhe grafikun e lëvrimin të mallrave.

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose  
b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

III.1.10. Operatori ekonomik ankimues pretendon se:

“OE Medfau ka ofruar mallrat e kërkuara nga AK (reagentë dhe aksesore) me kushtin e dhënies në përdorim prej tyre të pajisjes/pajisjeve të ndryshme nga ARCHITECT ci8200 dhe ARCHITECT i2000SR.

Njoftimi i Kontratës dhe Dokumentat e Tenderit (DT), që hartohen bazuar në Urdherin e Prokurimit përkatës, kanë përcaktuar që objekti i kontratës është "Blerje Reagente, dhe aksesore të tjera re nevojshem per testimet ne laboratorin e agjenteve infektive".

Pra, na rezulton, se dhenia në përdorim e pajisjes/pajisjeve, është një element që nuk është kërkuar nga AK në Dokumentat e Tenderit, cka del jashtë objektit të përcaktuar nga vetë AK në Urdherin e Prokurimit dhe DT.

OE Medfau, e ka objektivisht të pamundur të ofrojne reagentë dhe aksesore të tjerë nga prodhuesit e pajisjeve ARCHITECT ci8200 dhe ARCHITECT i2000SR, ose mallra ekuivalentë, pasi kjo deshmohet lehtësisht nga Autorizimi i Prodhuesit i datës 24.01.2019 i depozituar nga ana jone ne SPE, ku prodhuesi Abbot deklaroi qartësisht se:

*"ARCHITECT ci8200 dhe ARCHITECT i2000SR jane sisteme te mbyllura qe funksionojne vetem dhe ekskluzivisht me reagente dhe materiale konsumi te Abbot".*

*2. Përgjegjësite që u janë ngarkuar Operatorëve ekonomikë në Dokumentat e Tenderit janë ato që lidhen me furnizimin e AK me reagente dhe aksesore të tjerë të nevosjhmë për testimet në laboratorin e agjenteve infektive sipas specifikimeve, kushteve dhe afateve të kërkuara prej AK në DT.*

*KVO nuk mund të pranojë ofrimin e pajisjeve në përdorim nga OE Medfau, si kusht për furnizimin e mullrave të kerkuar nga AK. pasi kjo është një përgjegjësi e papërcaktuar në e dokumentat e tenderit. Pra KVO duke e pranuar dicka të tillë ka shkelur nenin 51/2 të LPP që përcakton: "Një ofertuesi si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet ti kërkohet që të ndër marrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentat e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën".*

*3. KVO nuk mund të marrë një vendim qe autorizon marrjen në përdorim të një pajisjeje të ndryshme nga ajo qe AK disponon si pjesë e inventarit aktual kur dicka e tille nuk është përcaktuar në Urdhërin e Prokurimit dhe ne Dokumentat e Tenderit, pasi do te ishte shkelje Udhëzimit te MF Nr. 30 date 27.12.2011 "Per menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" si dhe e Urdhërit nr. 3272, date 11.09.2007 të Ministrit të Shëndetësisë "Politikat Kombëtare të Pajisjeve Mjekësore". Se pari Udhëzimi i MF Nr. 30 date 27.12.2011 "Per menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" përcakton se: "35. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në Iibrat e kontabilitetit bazohet ne dokumenta origjinale që përdoren për kete qellim dhe grupohen në: a) Dokumenta autorizues jane ato dokumenta që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkelidhet dokumentit vertetues. Të tilla jane urdhërat e blerjeve. kontratat, urdhëri per krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashte përdorim itetj.*

*b) Dokumenta vërtetues vërtetojnë kryerjen ne fakt dhe ne menyre kronologjike të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletehyrjet. faturat. situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet. Mandat arketimet, mandatpagesat, procesverbalet, dhe te tjera akte me natyre verifikues shpenzimi.*

*c) Dokumente të kontabilitetit -janë dokumenta! permbledhes ose rregjistrat kontabel (libri i madh. Iibra analitike, kartelat e aktiveve. egi) të cdo lloj forme të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve te kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.*

*36. Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe te tjera të dhëna te nevojshme që i japin dokumentit forcën e nje prove ligjore ose administrative.*

*Pra, duket qartë, se në rastin konkret nuk ka një dokument autorizues për marrjen në përdorim ose me dhurim te pajisjeve, por Urdhëri i Prokurimit ka autorizuar vetëm blerjen e materialeve te konsumit për pajisjet që janë efektivisht giendje në QKTGJ.*

*Së dyti, Urdhëri nr. 3272, datë 11.09.2007 të Ministrit të Shëndetësisë "Politikat Kombëtare të pajisjeve mjekësore percakton nder te tjera:*

*"Në pikën 3.1.5*

*Procedura e prokurimit të investimeve kapitale në pajisje mjekësore fillon me përshkrimin e nevojave për një pajisje mjekësore dhe mbaron me një test pranimi për të. Skemat e prokurimeve të pajisjeve mjekësore jepen ne figurat 2 dhe 3.*

*Kërkesat për pajisje mjekësore duhet të bazohen në nevojat klinike. Procedura e prokurimit mund të ndahet në disa aktivitete të njëpasnjëshme.*

*Nevojat mjekësore nga përdoruesit*

*0 Vendimi nga menaxhuesit*

*Vleresimi i teknologjisë*

*Specifikimet e kërkesave të prodhimit që nevojitet*

*Blerja (Procedura e tenderit)*

*Pranimi i tenderit*

*0 Vendimi nga menaxhuesit*

*Kontraktimi i shitësit/furnizuesit! Të përzgjedhur*

*Dorëzimi dhe instalimi*

*Testi i pranimit dhe kontrolli teknik*

*Përdorimi klinik (Trajnimi i përdoruesve)*

*o Pranimi të raportohet tek menaxhuesi i cili jep lejen për pagese*

*Pagesa nga zyra e finances*

*Garancia*

*Në pikën 3.2*

*Dhurimi i pajisjeve mjekësore është një zgjedhje e dëshiruar nga shumë organizata të kujdesit shëndetësor. Megjithatë dhurimi i pajisjeve mjekësore duhet të jetë në përputhje me të njëjtat politika dhe standarde që zbatohen për prokurimin e pajisjeve të reja mjekësore. Në përgjithësi nuk duhet të ketë dallim nëse pajisja mjekësore është dhuruar apo prokuruar sipas procedurës që përshkruhet në nëndarjen 3.1.*

*Edhe për dhurimet e pajisjeve mjekësore, kuptohet që është e nevojshme të kete procedura që duhen zbatuar gjatë procesit të dhurimit dhe që iu përgjigjen pyetjeve të ndryshme që ngrihen në këtë rast.*

*Kur një marrës pranon një pajisje mjekësore si dhuratë, ai është përgjegjës që pajisja mjekësore të përdoret në mënyrë të sigurtë dhe me efikasitet. Për të qenë të qarta mbi ndikimin ekonomik që një pajisje mjekësore e dhuruar do të ketë në të ardhmen, duhet të bëhet gjithmonë një vlerësim i plotë i kostove të gjithë kohës së përdorimit të pajisjes (kosto e ciklit të jetës).*

*Në pikën 3.4.5*

*Materialet e konsumit dhe aksesorët që janë pjesë e pajisjeve mjekësore dhe duhet të përdoren në kombinim me to, duhet të blihen sipas rekomandimeve të prodhuesit të pajisjes. Vetëm nëse ndiqen rekomandimet e prodhuesit ky i fundit mund të garantojë siguri dhe performancën e pajisjes mjekësore. Blerja e aksesorëve të ndryshëm nga ato të rekomanduar nga prodhuesit duhet të parandalohet.*

*Pra për sa kohë që Urdhëri i Prokurimit dhe Dokumentat e tenderit nuk kanë përcaktuar shprehimisht që objekti i prokurimit përfshin edhe dhënie në përdorim ose dhurimin e pajisjes, kjo nuk mund të pranohet pasi edhe pranimi i dhurimit/marrjes në përdorim duhet të kalojë të njëjtat procedure si blerja me prokurim e pajisjes.*

Nëse AK do të kishte parashikuar edhe pranimin e dhenies ne perdorim te aparaturës, Dokumentat e Tenderit do të ishin ndërtuar si ne proceduren me nr. REF 59375-03-28-2018, me objekt "Blerje kite reagente per testimin me metoden NAT (përfshire venien ne perdorim te aparatit sipas specifikimeve te DST, ku jo vetem është percaktuar ne menyre specifike kerkesa per dhënien ne përdorim të aparaturës. por jane percaktuar edhe kërkesat dhe Specifikimet ne lidhje me të.

Në Dokumental e tenderit, pikën 2.14 te "Njohimit te Kontratës", nga AK është percaktuar qartë që nuk do te pranohen variantet.

OE Medfau duke ofruar mallrat e kerkuara të shoqëruara me kushtin e dhenies ne përdorim të pajisjeve te ndryshme nga ato qe disponon AK. te pakërkuara nga AK. jane në kushtet e ofertës alternative e cila sipas kushteve të Dokumentave të Tenderit nuk lejohet.

Neni 54 i LPP përcakton që ofertat alternative nuk lejohen, nëse nuk janë autorizuar nga AK.

4.

Përcaktimi i termit "ose ekuivalent" ne Specifikimet Teknike i referohet mallrave te kërkuara nga AK, në rastet kur ato mund te ofrohen nga prodhuets të ndryshëm nga prodhuesit e paisjeve, por gjithmonë me kusht që produktet e tyre (i) te përputhen me kërkesat e autoritetit kontraktor, (ii) të përmbushin te gjithë specifikimet teknike dhe (iii) të jene funksionale për nevojat e AK.

Ne rastin konkret produktet e ofruara nga OE Medfau nuk i përmbushin këto kushte, pasi prodhuesi i aparaturave ARCHITECT ci8200 dhe ARCHITECT i2000SR në Autorizimin e Prodhuesit te depozituar nga OE Pegasus. sh.p.k., deklaroi se këto aparatura janë sisteme të mbyllura që funksionojnë vetëm me aksesoret e ofruar nga ky prodhues.

5.

OE Medfau, nuk e ka të drejtën e tregtimit dhe vënies në treg të pajisjeve që kanë ofruar në përdorim dhe as të reagentëve dhe aksesorëve te lidhur me to. Prodhuesi që ne përfaqësojmë, ka ardhur në dijeni se OE Medfau si kusht për funizimin e reagenteve dhe aksesorëve të tjerë, ka ofruar për te dhënë në përdorim ne këtë procedurë prokurimi pajisjet ADVIA Centaur XPT, Dimension EXL200 dhe Immulite 2000 te prodhuesit Siemens Healthcare Diagnostic GmbH.

Ligji Nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore", ne nenin 13 përcakton se: "1. Te gjitha pajisjet mjekësore që vendosen në treg ne Republikën e Shqipërisë duhet të regjistronen ne regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore që mbahet nga Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Aplikimi për regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore paraqitet nga: a) prodhuesit e pajisjeve mjekësore që kanë të regjistruar aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, b) përfaqësuesit e prodhuesve të huaj që kanë të regjistruar aktivitetin në Republikën e Shqipërisë; c) tregtuesit me shumicë të pajisjeve mjekësore.

2. AKBPM-ja Iëshon një certifikatë per regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombetar të pajisjeve mjekësore brenda 30 ditëve nga data e marries së aplikimit.

Nga konsultimi i Regjistrit te pajisjeve mjekësore ne faqen ëeb te Agjencise Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (ëëë.akbpm.gov.al/dokumenta/Pajisje Mjekësore.xlsx), na rezulton se as OE Medfau dhe as OE Swissmed nuk i kane te regjistruara këto pajisje dhe reagentët përkatës në këtë regjistër, pra sipas nenit 13 me sipër. nuk e gëzojnë të drejten a tregtimit të tyre. Më konkretisht:

<i>OE MEDFAU</i>	
<i>Pajisja e ofruar</i>	<i>Pajisje në Regjistër AKBKPM</i>
<i>Advia Centaur XPT</i>	<i>Advia 360 Hamatology System</i>
<i>Dimension EXL200</i>	<i>DimensionR RcL Max R</i>
<i>Immulite</i>	<i>Immulite R 1000 030006</i>

6.

*Në Shtojcën 10 të DT është përcaktuar që kërkohen: "Reagente dhe aksesore të tjera të nevojshme për testimet në Laboratorin e Agjenteve Infektivë për agjentë infektivë dhe bilanc/testime biokimike me analizatorin ARCHITECT ci8200 dhe ARCHITECT i2000SR ose ekuivalent".*

*Sic është shprehur dhe në dokumentat e tenderit kërkohen teste për 2 analizatore: ARCHITECT ci8200 sistemi i integruar dhe ARCHITECT i2000SR analizator. Pra AK ka në pronësi të tij përveç sistemit të integruar ARCHITECT T ci8200 edhe aparatoren ARCHITECT i2000SR që shërben si backup në rast të ndonjë difekti. Në rezultatet OE Swissmed dhe Medfau nuk kanë ofruar ndonjë pajisje/analizator ekuivalent me ARCHITECT i2000SR që shërben si backup platformën e integruar.*

*Në fakt OE Medfau nuk ka ofruar as pajisje ekuivalente të pajisjes primare (platformes së integruar). Në rast të ndonjë difekti në aparaturë kush do ta mbulojë testimin derisa aparatura e ofruar nga këta operatorë do të rregullohet. Duke qenë që QKTGJ është e vetmja në Shqipëri që teston gjakun, mosfunksionimi dhe për një ditë të vetme për shkak të difekteve do të sillte pasoja shumë të rënda si pasoje e mungesës së testimit të gjakut dhe për shkak të numrit përgjithësisht të vogël të dhurimeve në Shqipëri".*

III.1.11. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimes argumenton se:

*Në dokumentat e tenderit konkretisht në kriteret e veçanta të kualifikimit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi rezulton se ndër të tjera është kërkuar:*

- 4. Operatori ekonomik duhet të vetdeklarohet origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese,*
- 5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë për të gjithë artikujt e lotit për të cilin konkuron, në katalog duhet të markohen artikujt e ofruar,*
- 6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese apo distributorët e autorizuar për tregëtimin e artikujve të ofruar të përkthyer dhe të noterizuar.*

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Medfau shpik në përmbushje të kriterëve sa më sipër rezulton se është dorëzuar:*

- 4. Autorizim prodhuesi lëshuar nga prodhuesi Siemens Healthineers të cilët janë përfaqësuesit ligjorë të laboratorit dhe reagentëve, produktet e konsumueshme, datë 18 shkurt 2019 me anë të së cilës autorizohet shoqëria Medfau shpik të dorëzojë dhe të ofrojë pajisjet Advia Centaur XPT, Immulite 2000, Dimension EXL 200 dhe reagentët dhe konsumatorët për këto pajisje me qëllim pjesëmarrje në tenderin me objekt blerje reagent dhe aksesore të tjera të nevojshme për testimin në laboratorin e agjentëve infektivë.*



5. *Katalogët teknikë për Anti HCV, HIV Ag/Ab (combo), Sifiliz TP, CMV igG, Alt, Ferritin, Cholesterol, Trigliceride, Protein totale, Kreatinemi*

6. *Deklaratë për origjinën e mallit Datë 07.03.2019.*

*Në nenin 46 pika 1 gërma b të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: [...]*

*Në nenin 53[...]*

*Në nenin 27 të VKM 914, datë 29.12.2014[...]*

*Referuar bazës ligjore si më sipër KSHA gjykon se operatori ekonomik Medfau shpk ka dorëzuar dokumentacion në përputhje me kriteret kualifikuese.*

*Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes Pegasus shpk se operatori ekonomik Medfau shpk është kualifikuar në këtë procedurë në bazë të një kriteri të pakërkuar, pasi ka ofertuar përveç mallrave objekt prokurimi edhe pajisjet në përdorim, KSHA gjykon se në dokumentat e procedurës së prokurimit, kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specififikimet teknike nuk është përjashtuar një mundësi e tillë. Vërtet autoriteti kontraktor ka hartuar specififikimet teknike në varësi të pajisjeve që disponon, por kjo nuk do të thotë që është përjashtuar kategorikisht mundësia që këto pajisje të disponohen dhe ofrohen edhe nga ofertuesit, mjafton që malli i kërkuar të jetë në përputhje me specififikimet teknike të vendosura pavarësisht pajisjeve që do të përdoren për realizimin e testimeve përkatëse”.*

III.1.12. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Medfau” sh.p.k. konstatohet se është paraqitur si më poshtë:

- Shtojca 1 Formulari i ofertës, ku në tabelën e formularit është shtuar edhe një kolonë e emërtuar “Kompania Prodhuese/MAH”, ku evidentohet se është deklaruar kompania “Siemens”;
- Autorizimi i prodhuesit nga kompania Siemens Healthineers ku përcaktohet se: “Ne Siemens Healthcare Diagnostics GmbH të cilët jemi përfaqësues të Prodhuesit Ligjor të Laboratorit, Pajisjet dhe reagentët, produktet e konsumueshme me këtë autorizojmë Medfau shpk për të dorëzuar një ofertë qëllimi i së cilës është të ofrojmë pajisjen tonë Advia Centaur XPT, Immulite 2000, Dimensioni EXL 200 dhe reagentë dhe konsumatorë për këto pajisje, siç ju kërkoni në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut[...].”
- Deklaratë e operatorit ekonomik Medfau sh.p.k. ku deklarohet: “Deklarojmë që në ofertën tonë janë të përfshira 3 pajisje të reja të kompanisë prodhuese Siemens, prodhim i vitit 2018 model Advia Centaur XPT, Immulite 2000 dhe Dimension EXL 200. Këto pajisje mbulojnë 100% gamën e testeve që kërkohen nga ju në këtë prokurim dhe duke pasur parasysh që pajisjet ekzistuese që ju keni janë të amortizuara, me këto pajisje të reja të ofruara nga ne do të ofrojmë një cilësi më të mirë dhe saktësi më të lartë. Deklarojmë se për artikujt e ofruar në këtë procedurë prokurimi kompania prodhuese është Siemens dhe vendi i prodhimit është USA dhe United Kingdom sipas listës së plotësuar në formularin e ofertës. Deklarojmë që brenda kësaj vlere oferte është e pëfshirë edhe mirëmbajtja e aparaturave të ofruara nga ne në këtë procedurë prokurimi (Advia Centaur XPT, Immulite 2000 dhe Dimension EXL 200)

- Specifikimet teknike ku deklarohet se: “Kitet do të jenë të përshtatshme për përdorim me aparaturën plotësisht automatike, testime për agjentë infektivë dhe ato biokimike, në pajisjet e ofruara në këtë procedurë prokurimi Siemens modele Advia Centaur XPT, Immulite 2000 dhe Dimension EXL 200.[...] Brenda kësaj vlere oferte është e përfshirë edhe mirëmbajtja e aparaturave të ofruara nga ne në këtë procedurë prokurimi (Advia Centaur XPT, Immulite 2000 dhe Dimension EXL200)
- Sasia dhe grafiku i lëvrimit Lot.1, ... Reagentë dhe aksesorë të tjerë të nevojshëm për testimet në Laboratorin e Agjentëve Infektivë për agjentë infektivë dhe bilanc/testime biokimike me analizatorin Advia Centaur XPT, Immulite 2000 dhe Dimension Exl 200.

III.1.13. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.1.14. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.15. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë të interesuar duhet të kryejnë furnizimin me aksesorë dhe reagent, pra procedura e prokurimit është blerje reagentë dhe aksesorë, të cilët duhet të jenë kompatibël me pajisjet ekzistuese që janë aktualisht në përdorim nga ana e autoritetit kontraktor, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe konkretisht pajisjet e ARCHITECHT ci8200 dhe ARCHITECHT i2000SR.

Në asnjë moment nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit nuk është përcaktuar se kërkohet kryerja e shërbimit të pajisjeve, së bashku me reagentët dhe aksesorët, por është përcaktuar vetëm blerja e mallit dhe procedura është publikuar si procedurë blerje. Autoriteti kontraktor ka përcaktuar si objekt prokurimi thjesht blerjen e reagentëve dhe aksesorëve, si edhe ka përcaktuar në dokumentat e tenderit vetëm pajisjet që ajo ka aktualisht në përdorim dhe për të cilat duhet të blihen reagentët dhe aksesorët, pra në asnjë moment nuk ka përcaktuar në dokumentat e tenderit se, pajisjet që ka aktualisht në përdorim nuk do të përdoren më dhe që të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të ofrojnë reagentët së bashku me pajisjet e tyre që përshtaten me këto reagentë.

III.1.16. Në legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe konkretisht Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, përcaktohet se:

“35. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumenta origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:

a. Dokumenta autorizues - janë ato dokumenta që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Te tilla janë urdherat e blerjeve, kontratat, urdheri për krijimin e komisioneve, urdher për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.

b. Dokumenta vërtetues - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arketimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.

c. Dokumente të kontabilitetit - janë dokumentat përmbledhës ose rregjistrat kontabel (libri i madh, librat analitike, kartelat e aktiveve, etj) të çdo lloji forme 11, bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

36. Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vertetesi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdheruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative<sup>12</sup>. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminohen mundësinë për gabime, harresa, numerim të dyfishtë si dhe ato të mashtrimeve”.

37. Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i cmimit (Procesi i marrjes në dorezim të aktiveve, referuar kushteve të percaktuara në kontrate).

38. Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve.

39. Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë. Aktivitet që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje, pasqyrohen me dokumente të përkohshme, por fletëhyrja ose fletëdalja për gjithë sasinë plotësohet me mbritjen e gjithë sasisë së aktivitetit, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme. 40. Magazinieri dorezon tek nepunesi përgjegjës për financat e njesisë nga një kopje origjinale për flete hyrjet, faturen e furnizuesit (shitesit) si dhe flete daljen, si dhe hedh në 11 Sipas percaktimit në nenin 4/26 të ligjit 10296 dhe të nenit 3/1 të Ligjit 10 273, datë 29.4.2010 “Per Dokumentin elektronik”. 12 Sipas percaktimit në Nenin 4/26 të ligjit 10296, datë 8.07.2010 “Per MFK” 9 kartelat e magazines levizjet perkatese në sasi dhe në vlerë sipas afateve të percaktuara nga njesite publike në funksion të specifikës së aktivitetit të tyre.

41. Në rast të caktuara sipas nevojave të njesisë publike, behet dërgimi i aktiveve drejtpërdrejt nga furnizuesi ose dhuruesi të përdoruesi (p.sh direkt në njesinë shpenzuese të njesisë publike) dhe bëhen hyrje e dalje pa kaluar në magazinë (p.sh. në magazinën qendrore të njesisë publike). Në këto rast duhet të miratohen nga Nepunesi Autorizues i njesisë publike procedura të qarta të levizjes, të shoqëruara me përgjegjësitë respektive. Veprimet behen në prani të punonjësve të ngarkuar me administrimin e aktiveve”.

Nga ana tjetër, është vetë autoriteti kontraktor ai që ka përcaktuar në dokumentat e tenderit që nuk do të pranohen variantet, kur ndërkohë kualifikon ofertën e një operatori ekonomik i cili oferton me produkte të pajisjeve të tjera në kundërshtim të specifikimeve teknike të hartuara dhe përcaktuara në dokumentat e tenderit, madje duke lejuar edhe ofertimin e pajisjeve për këto reagentë, ndërkohë që objekti i prokurimit është vetëm blerja e reagentëve dhe aksesorëve. Autoriteti kontraktor nuk mund të lejojë marrjen në përdorim të një pajisje tjetër nga ajo që vetë autoriteti kontraktor disponon, në kundërshtim me përcaktimet e tenderit ku ka përcaktuar vetëm

blerjen e mallit, e për më tepër që një gjë e tillë nuk është përcaktuar dhe nuk është kërkuar në dokumentat e tenderit. Sqarojmë se, pranimi i marrjes në përdorim i pajisjeve, referuar si udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë ashtu edhe legjislacionit për prokurimin publik, duhet të bëhet nëpërmjet procedurave të prokurimit sipas përcaktimeve të bëra në këtë legjislacion.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kualifikimi i operatorit ekonomik “Medfau” sh.p.k., oferta e të cilit përfshin ofrimin e reagentëve dhe aksesorëve së bashku me pajisjet për këto reagentë, në kushtet kur objekti i prokurimit është blerje mallra, vjen në kundërshtim me përcaktimet e bëra në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, si edhe shkakon diskriminim dhe konkurrencë të pandershme për operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës.

III.1.17. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.18. Sqarojmë se, në rast se operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor përsa i përket dokumentave të tenderit, specifikimeve teknike etj., publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar parashikohet se: *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme, ai gjithashtu ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së.

Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

III.1.19. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.1.20. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Medfau” sh.p.k. në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Medfau” sh.p.k. qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Medfau” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i është pranuar një prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e përrjedhojë duke përmbushur interes të ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

III.3. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Swissmed” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit për të cilin paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët ekonomikë të renditur me vlerë ekonomike më të lartë se vlera e ofertës së tij ekonomike.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Pegasus” sh.p.k., mbi ofertën e operatorit ekonomik “Swissmed” sh.p.k., nuk do të merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Pegasus” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur*”, me nr. REF-07294-02-11-2019, Loti I, me objekt: “*Blerje Reagenë, dhe aksesore të tjerë të nevojshëm për testimet në laboratorin e agjentëve infektivë*”, me fond limit 97.430.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut.
  2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Medfau” sh.p.k. dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
  3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Pegasus” sh.p.k
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 593 Protokolli**

**Datë 01.04.2019**

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Enkeleda Bega</b>	<b>Vilma Zhupaj</b>	<b>Lindita Skeja</b>	<b>Merita Zeqaj</b>

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**